

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS SË SIGURIMIT TË BANESAVE

Në bazë të marrëveshjes ndërmjet palëve, Shoqëria e Sigurimeve do të dëmshpërblejë për dëmet e ndodhura në banesën e siguruar, në mënyrë të papritur, të paparashikuar dhe aksidentale, në përputhje me kushtet e kontratës, brenda periudhës së sigurimit.

Neni 1

TERMA TË PËRGJITHSHËM

1.1 “Siguruesi” kupton Shoqërinë e Sigurimit (Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group) që lëshon këtë kontratë.

1.2 “I Siguruari” kupton personin fizik ose juridik, interesi i të cilit mbrohet nga kontrata e sigurimit.

1.3 “Perfaqesuesi” kupton personin fizik ose juridik të cilit i jepet e drejta të lidhe dhe nënshkruaje kontratën e sigurimit.

1.4 “Kontrata” është marrëveshja e lidhur midis Siguruesit dhe Të Siguarit.

SEKSIONI I: SIGURIMI I PRONËS

Neni 2

OBJEKTI I SIGURIMIT

Objekte sigurimi sipas këtyre kushteve janë:

2.1 Objektet e banimit (banesat dhe vilat) të përcaktuara shprehimisht në policën e sigurimit në të cilën janë të përfshira edhe ndërtesat/pjesët bashkëngjitur objektit të banimit (garazhd ... etj), nëse ka të tilla.

2.2 Pajisjet shtëpiake të cilat ndodhen në objektin e banimit të siguruar dhe i shërbejnë për përdorim të siguarit apo antarëve të tjerë të familjes.

Objekti i banimit konsiderohet banesa ku i siguruari ka vendbanimin e përhershëm, e cila nuk ka qenë e pabanuar pa ndërprerje për më shumë se 60 ditë gjatë 12 muajve.

Pajisjet shtëpiake konsiderohen të gjitha orenditë dhe objektet të cilat përdoren dhe konsumohen në shtëpi, të tilla si: mobiljet, pajisjet elektro-shtëpiake, garderoba e të siguarit dhe antarëve të tjerë të familjes, enët e kuzhinës, veglat e punës, antenat, depozitat e ujit, panelet diellore etj.

2.3 Shpenzimet për sistemimin e nevojshëm të të Siguarit dhe antarëve të tjerë të familjes se tij në një banesë të përkohëshme me qera, në rastin e dëmtimit të objektit të banimit të siguar i cili është bërë e pabanueshem, nga njëri prej rreziqeve të sigurimit të përcaktuara në Nenin 3 të këtyre kushteve. Afati kohor, gjatë të cilit i Siguruari do të përfitojë pagesën e qerasë, do të përcaktohet nga ekspertët.

2.4 Heqja e mbeturinave

Heqja e mbeturinave do të konsiderohen shpenzimet e nevojshme për pastrimin e mbeturinave të shkaktuara nga ndodhja e rreziqeve të sigurimit të përcaktuara në Nenin 3 të këtyre kushteve.

Sipas këtyre kushteve, nuk përfshihen në objektin e sigurimit të kësaj kontrate: hidrovoret jashtë përbërjes së ndërtesës, pusët, cisternat e ujit, mjetet motorike në të cilin përfshihen (pajisjet dhe aksesoret e tyre, aparatat elektronike të cilat ndodhen në mjetin motorik), bicikletat me motor ndihmës, karrocitet dhe të gjitha llojet e objekteve lundruese, makineritë e punës, rezervat e materialeve dhe të mallrave që shërbejnë për ushtrimin e veprimtarisë profesionale, metalet apo gurët e çmuar të papërpunuara, produktet ushqimore, kafshët, zogjtë, peshqit. Të gjitha llojet e dokumentave që i Siguruari mban në banesën e tij. Të dhënat elektronike të rregjistruara në disketa ose disqe dhe kartat e kreditit. Objekte që janë siguruar më vete nga kjo kontratë ose nga një kontratë tjetër sigurimi. Sende të cilat jepen ose merren me qera nga “I Siguruari”.

Neni 3

RREZIQET E SIGURUARA

Siguruesi është i detyruar të kompensojë dëmet si shkatërimi ose dëmtimi i objekteve dhe sendeve të siguruara, sipas Nenit 2 të këtyre kushteve, të shkaktuara nga keto rreziqe:

3.1 Zjarri dhe rreziqe të ngjashme, si me poshte:

Zjarr do të konsiderohet të jetë një formë e djegjes me flakë e të mirave materiale jashtë vatrës që ekziston qëllimisht për të, e aftë të vetëpërhapet dhe të vetëzgjerohet.

Rrufeja. Rrufe do të konsiderohet të jetë një shkrepje e rrufesë, e cila godet një objekt drejtpërdrejt.

Eksplozioni dhe implozioni, do të konsiderohet veprimi i menjëhershëm dhe i dhunshëm i presionit/depresionit të gazit ose avullit dhe shpërthimit të tij.

Rënia e avionit ose mjeteve të tjera ajrore. Rënia e objekteve nga këto mjete, të cilat mund të shkaktojnë dëm në objektin e siguruar.

Nuk mbulohen:

a. Demet e shkaktuara nga eksplozioni me dinamit ose cdo lloj tjetër eksplozivi, që i Siguruari mund të ketë në banesë.

- b. Demet e shkaktuara nga goditja me objektet e banimit te siguruar e një automjeti.
- c. Dëmet e shkaktuara me dashje ose nga pakujdesia e të Siguruarit ose anëtarëve madhorë të familjes së tij.
- d. Dëmet e shkaktuara nga lidhja e shkurtër dhe mbitemsoni, që lindin në pajisjet elektrike me ose pa flakë, që nuk shkaktohen nga zjarri ose eksplozioni.
- e. Dëmet e shkaktuara në kontaktet e çelësve elektrikë si rrjedhojë e presioneve të gazrave që lindin brenda tyre.
- f. Dëmet në çdo makineri ose aparaturë elektrike, ose në çdo pjesë të instalimit elektrik si pasojë e rrufesë, nëse ky dëm nuk është shkaktuar nga goditja direkte e rrufesë.

3.2 Stuhia dhe rreziqe të ngjashme, si me poshte:

Siguruesi do të paguajë të Siguruarin për dëmet e shkaktuara në objektin e siguruar nga veprimi direkt i:

3.2.1 Stuhisë, që nënkupton lëvizjen e ajrit me forcën e erës jo më të vogël se 8 (sipas shkallës së Boforit) ose me shpejtësi 17.2 m/sek ose 62 km/orë, të shkaktuara nga kushtet meteorologjike. Do të sigurohen vetëm dëmet që shkaktohen nga efektet e drejtpërdrejta të stuhisë në objektin e siguruar ose nga stuhia që shkakton rënien e pjesëve të ndërtesave, pemëve ose objekteve të tjera në objektin e siguruar. Në qoftë se forca e erës përreth objektit të siguruar nuk mund të përcaktohet, do të konsiderohet stuhi, në rast se i Siguruarit provon që levizja e ajrit ka shkaktuar dëme edhe tek ndërtesat me kushte të rregullta ose objekte me rezistencë të njëjtë përreth objektit të siguruar.

3.2.2 Pesha e akullit, borës, mbi çati që shkakton dëme në objektin e banimit.

Nuk mbulohen, dëmet që ndodhin ne:

a. Objektet e banimit, të cilat nuk janë të lidhura me tokën, nuk janë të mbyllura dhe të mbuluara plotësisht, si dhe dëmet në pajisjet shtëpiake, sendet me vlerë, paratë, koleksionet, objektet artistike, që ndodhen në këto objekte.

b. Ndërtesat bashkëngjitur, si garazhd, veranda etj... të cilat janë ndërtuar më shumë se 50% me material të lehtë ose në të cilat perberja e mbuleses është më shumë se 20% me material të lehtë.

Material i lehtë nënkupton drurin dhe materialet që rrjedhin prej tij, materialin plastik, kallamin, kashtën, kartonin ose fletët e bitumit.

c. Në strehët, qepenët, mushamatë e jashtme, antenat, panelet diellore, depozitat e ujit, telat ajrore dhe mbajtësit e tyre.

d. Në pjesën e jashtme të oxhaqeve, në kanatat, grilat dhe tendat e dritareve, në qoftë se thyerja/dëmtimi e tyre nuk është shoqëruar me një prishje pjesore të ndërtesës së siguruar.

3.3 Tërmeti

Janë të mbuluara dëmet e ndodhura nga:

Tërmeti, i cili duhet të jetë i rregjistruar nga stacionet sizmike, si dhe të ketë një vlerë jo më të vogël se 4 Ballë sipas shkallës Rihter dhe ndërtimi i banesës të jetë berë në përputhje me kushtet sizmike të zonës.

Nuk mbulohen, dëmet që ndodhin në:

a. Themelet e ndërtesës.

b. Afresket, zbukurimet murale dhe pikturat.

c. Enët ujëmbajtëse (depozitat) të vendosura në mure.

d. Dëmet e shkaktuara nga përmbytja, vërshimi, valët e baticës.

Siguruesi do të dëmshperblejë të Siguruarin për dëme të ndodhura nga tërmeti, nëse ky i fundit vërtetohet nga organi publik kompetent (Instituti Sizmik).

3.4 Përmbytja, që do të konsiderohet rasti kur:

3.4.1 Uji i shtratit të qëndrueshëm, (lumit, liqenit, detit) përmbyt rastësisht objektet e banimit te siguruara.

3.4.2 Vërshimi i ujit ndodh për shkak të shiut të madh, të papritur, si dhe vërshimi rastësor për shkak të rreshjeve shumë të mëdha.

3.4.3 Ky sigurim mbulon vetëm dëmet e shkaktuara në objektet e siguruara gjatë vërshimit ose menjëherë pasi uji ka vërshuar.

Nuk mbulohen, dëmet që ndodhin për shkak të:

a. Veprimet/vershimit të ujit si pasojë e dëmtimit ose amortizimit të tubacioneve të ujit, të kanaleve dhe tuneleve.

b. Kalbëzimit të thatë.

c. Fundosjes ose uljes së tokës, që rrjedh nga përmbytja.

d. Ndikimit të ujit të nëndheshëm në pilota, gropa themeli ose punime të ndryshme.

e. Ujit të ardhur prej sistemeve të vaditjes, me kusht që vërshimi i tij jashtë nuk është pasojë e përmbytjes.

Ky sigurim nuk do të mbulojë dëmet në ndërtesat e ngritura mbi ujë, n.q.se nuk është rënë dakord ndryshe.

Siguruesi do të dëmshperblejë të Siguruarin për dëme të ndodhura nga përmbytja nëse kjo e fundit vërtetohet nga organi kompetent (Instituti Meteorologjik).

3.5 Dëmet nga uji, që nënkupton dëmet që mund të ndodhin për shkak të rrjedhjes së ujit nga tubat e furnizimit ose të shkarkimit të rrjetit kryesor të ujit, të cdo pajisje tjetër të lidhur me sistemin e tubave, instalimeve të ujit të ngrohtë, pajisjeve të lidhura me sistemin e ajrit të kondicionuar, pompat e ujit të nxehtë ose të sistemeve të ngrohjes diellore. Avulli do të konsiderohet të ketë të njëjtin status si uji i tubave.

Nuk mbulohen, dëmet që ndodhin nga:

a. Rrjedhja ose prishja e kanalizimeve nëntokësore.

- b.** Defektet nga mungesa e mirëmbajtjes dhe/ose të riparimit jo te duhur, që janë të njohura nga i Siguruari dhe të cilat ai nuk i ka deklaruar.
- c.** Të metat që kanë ardhur nga ndërtimi.
- d.** Depërtimi i ujit nëpërmjet çatisë si rezultat i shiut.
- e.** Dëmet e shkaktuara nga uji në rast se i Siguruari është larguar më shumë se 3 ditë nga shtëpia pa mbyllur saraçineskën kryesore.

3.6 Thyerja e xhamave

Mbulohet thyerja aksidentale vetem e xhamave të dyerve, dritareve dhe vetratave të objekteve te banimit të të Siguararit.

Nuk mbulohen:

- a.** Dëmet e shkaktuara nga thyerja aksidentale e xhamave të dyerve, dritareve dhe vetratave të banesës gjatë kryerjes së punimeve për vendosjen ose heqjen e tyre.
- b.** Gërvishtjet e xhamave.
- c.** Demet e shkaktuara ne objekte te tjera si: pasqyra prej xhami, tryeza etj.

3.7 Vjedhja,

Sipas kushteve të kësaj kontrate janë të mbuluara dëmet direkte shkaktuar nga vjedhja ose tentativa për vjedhje në objektet e banimit. Do të mbulohen gjithashtu dëmet direkte të shkaktuara në objektin e banimit si pasojë e vjedhjes.

Ky mbulim do te jetë i vlefshem Vetem n.q.se përmbushet njëri nga kushtet e mëposhtme:

3.7.1 Vjedhësi hyn ne mjediset e mbyllura të objektit te banimit ku ndodhen objektet e siguruar, duke thyer ose duke prishur dyert dhe dritaret ose duke hyre me forcë nëpërmjet tavanit, mureve ose dyshemesë.

3.7.2 Vjedhësi hap mjedisin e mbyllur të banesës me çelës të rremë ose me ndonjë mjet tjetër që nuk është paracaktuar për hapjen e rregullt të tij.

3.7.3 Vjedhësi hyn në vendodhjen e mbyllur në objektet e banimit, në rast se deri në vendodhje arrin nëpërmjet një prej veprimeve që, sipas dispozitave të kësaj pike cilësohet si vjedhje me thyerje.

3.7.4 Vjedhësi hyn pa u vënë re në banesë ose fshihet në të dhe kryen vjedhje kur banesa është e mbyllur.

3.7.5 Vjedhësi hap mjediset dhe vendodhjet e mbyllura në objektet e banimit me çelësa të vërtetë/originale ose kopjo të tyre, në rast se përvetesimin e çelësave e ka arritur nëpërmjet një prej veprimeve të përmendura në pikat 3.7.1 - 3.7.4, të kësaj pike.

3.7.6 Vjedhësi hyn në mjediset e mbyllura në objektet e banimit nëpërmjet një hapësire që nuk është paracaktuar për këtë qëllim, duke kaluar pengesat që pengojnë hyrjen pa rezistencë.

Nuk mbulohen, dëmet e ndodhura në objektet e banimit:

a. Gjatë periudhës së boshatisjes se tyre, të urdhëruar nga autoritetet per shkak te luftës, turbullirave civile ose gjatë sekuestrimit të tyre në përfitim të personave të tjerë.

b. Gjatë zënies me forcë të banesave nga një ose nga disa persona të tjerë, të cilët nuk janë të autorizuar nga i Siguruari.

c. Në qoftë se ajo ka qene e pabanuar për një periudhë më të gjatë se 30 ditë.

Nuk mbulohen gjithashtu dëmet të shkaktuara nga vjedhja ose tentativa për vjedhje:

d. Në anekset/hapesirat pa komunikim direkt dhe të brendshëm me banesën,

e. Në bodrumet kolektive dhe në ambjentet e përbashkëta, që përdoren jo vetëm nga i Siguruari, por edhe nga persona të tjerë.

f. Në rast se i Siguruari ose një nga personat me të cilët ai banon ka lënë hapur derën ose dritaret, ose pjese tjeter nga e cila mund te hyhet lehtesisht ne objektin e banimit.

g. E kryer nga i Siguruari personalisht ose në bashkëpunim me një person/a te tjere, që banojne ose jo me të.

DETYRIME

I Siguruari duhet:

a. Të përdorë të gjitha mjetet dhe te marre te gjitha masat e nevojshme për mbylljen e objektit te banimit (portat, dritaret, bravat, shulat...etj) kur nuk është i pranishëm personalisht ose familjaret e tij, qoftë edhe për një kohë të shkurtër të ditës ose të natës.

b. Të mbajë këto mjete të mbylljes dhe të mbrojtjes në gjendje të mirë dhe t'i mirëmbajë ato.

c. Në raste vjedhjeje të lajmerojë **menjëherë** policinë.

Në qoftë se një vjedhje është kryer kur i Siguruari nuk ka përmbushur njërin prej detyrimeve te mesiperme, Siguruesi do të refuzojë dëmshpërblimin.

Neni 4

GRUPIMI I RREZIQEVE

Për efekt të këtyre kushteve të përgjithëshme, rreziqet e sigurimit do t'i grupojmë sipas këtyre grupeve:

4.1 Grupi i parë: Sigurimi nga zjarri dhe rreziqe të ngjashme sipas pikës 1 të Nenit 3, Tërmeti (pika 3, Neni 3), të këtyre kushteve.

4.2 Grupi i dytë: Grupi i parë dhe Dëmet nga uji (pika 5, Neni 3).

4.3 Grupi i tretë: Grupi i dytë dhe Stuhia dhe rreziqe te ngjashme (pika 2, Neni 3), thyerja e xhamave (pika 6, Neni 3), Përmbytja (pika 4, Neni 3), Vjedhja (pika 7, Neni 3),

Ne cdo rast, mbulimi i pare i siguruar do te jete Grupi i Parë dhe me pas i Siguruari do të kete te drejte te zgjedhe edhe mbulimet për grupet e tjera të sigurimit.

Neni 5

VLERA DHE SHUMA E SIGURUAR.

5.1 VLERA E SIGURIMIT do të jetë:

5.1.1 për ndërtesat

Vlera e zëvendësimit: është vlera e ndërtimit të objektit te banimit e percaktuar nga Enti Kombetar i Banesave, duke përfshirë gjithashtu edhe shpenzimet e arkitektit, të prishjes, të pastrimit, të depozitimit ose të çmontimeve të nevojshme gjatë riparimit.

5.1.2 per pajisjet shtëpiake:

Vlera e zëvendësimit: është vlera që do të paguhet për blerjen ose prodhimin e sendeve të të njëjtit tip dhe cilësi në gjendjen qe ato kishin me pare, cilado qoftë shuma më e ulët.

5.1.3 për sendet me vlerë, koleksionet, objektet artistike: Vlera e zëvendësimit, e cila është vlera që do të paguhet për blerjen ose prodhimin e sendeve të të njëjtit tip, cilësi dhe vjetërsi në gjendjen qe ato kishin me pare, cilado qoftë shuma më e ulët

5.2. SHUMA E SIGURUAR

5.2.1 Për ndërtesat.

Shuma e Siguar do te percaktohet ne police dhe mund te jete e barabarte me vlerën e zevendesimit ose vleren e tregut.

5.2.2 Për pajisjet shtëpiake.

Shuma e siguruar si rregull do të jetë e barabartë me vlerën e zëvendësimit të tyre. Gjithsesi, shuma e sigurimit të pajisjeve shtëpiake do të jetë jo më shumë se 30% e vlerës së ndërtesës.

5.2.3 Shpenzimet për sistemimin e nevojshem të të siguruarit dhe anetarëve të tjerë te familjes se tij në një banesë te përkohëshme, do të mbulohen për një periudhë 12 mujore nga data e ndodhjes së demit dhe per te gjithë kete periudhe limiti maksimal i mbulimit nuk do te jete më shumë se 3% e vlerës së ndërtesës.

5.2.4 Për heqjen e mbeturinave limiti maksimal i mbulimit është 1,000 USD.

Neni 6

VLERA E DËMSPËRBLIMIT.

6.1 Për ndërtesat:

Ne cdo rast nuk do të jetë më e lartë se shuma e siguruar, me të cilën prona është marrë në sigurim, duke i zbritur pjesen e zbritshme.

Në rastin e dëmtimit ose shkatërrimit pjesor të objekteve te banimit si rrjedhim i një prej “Rreziqeve të Sigurimit”, Siguruesi do të dëmshpërblejë sipas vlerave të sigurimit apo shpenzimet e riparimit që dalin të nevojshme nga dëmtimi por jo më shumë se shuma e sigurimit të percaktuar më sipër duke zbritur amortizimin dhe vlerën e shpëtuar.

6.2 Për pajisjet shtëpiake

Ne rastin kur ato janë prishur/demtuar, shkatërruar ose vjedhur.

6.2.1 Dëmshpërblimi do të kryhet duke u bazuar në Vlerën e Zëvendësimit në ditën e ndodhjes së demit duke zbritur vlerën e pjesëve të shpëtuar, si dhe pjesen e zbritshme.

Vlera e shpëtuar do të quhet vlera e asaj pjese të pajisjes, e cila ka mbetur e padëmtuar në rast dëmi.

6.2.2 Nëse riparimi është i mundur, atëherë Siguruesi do të paguajë shumën e riparimit.

6.2.3 Për pajisjet e vjedhura Siguruesi do të dëmshpërblejë të Siguararin jo me parë se 90 ditë nga dita e njoftimit të demit. Në qoftë së objekti i vjedhur është zbuluar/gjetur nga organet kompetente përpara pagesës së dëmshpërblimit, i Siguruari është i detyruar që ta marrë atë në zotërim, ne rast se eshte e mundur.

Në qoftë se objekti i vjedhur është zbuluar/gjetur nga organet kompetente pas pagimit të dëmshpërblimit dhe i Siguruari ka mundesinë ta marrë atë në zotërim, atehere ky i fundit detyrohet të kthejë dëmshpërblimin e marrë nga Siguruesi.

Siguruesi do të dëmshpërblejë të Siguararin për dëmtimet e objekteve të vjedhura dhe shpenzimet për rikthimin e tyre, pas paraqitjes së proces-verbalit të policisë.

6.3 Për sendet me vlerë, koleksionet, objektet artistike

Vlera e zëvendësimit, e cila është vlera që do të paguhet për blerjen ose prodhimin e sendeve të të njëjtit tip, cilësi dhe vjetërsi në gjendjen qe ato kishin me pare, cilado qoftë shuma më e ulët

Neni 7

RIVENDOSJA E SHUMËS SË SIGURIMIT

Pas likuidimit të dëmshpërblimit objektet mbeten të siguruar deri në mbarim të afatit të kontratës së sigurimit për diferencë midis shumës së siguruar dhe dëmshpërblimit të paguar, duke bërë shënimet përkatëse në Policën e sigurimit (moskryerja e ketyre shenimeve ne policen e sigurimit nuk nenkupton qe objektet jane te siguruar me shumen fillestare te sigurimit). Me kërkesën e të Siguararit, shuma e siguruar mund të rritet për të arritur në shumën fillestare te sigurimit duke paguar prim shtesë në mënyrë porporcionale dhe duke bërë shënimet përkatëse në policën e sigurimit. **SEKSIONI II – SIGURIMI I PËRGJEGJËSISË**

Neni 8

OBJEKTI I SIGURIMIT

Objekt i këtij sigurimi janë dëmet materiale dhe/ose shëndetësore që mund t'u shkaktohen palëve të treta nga i Siguruari dhe/ose personat me të cilet ai banon.

Dëme shëndetësore nënkupton të gjitha plagosjet dhe dëmtimet fizike aksidentale të personave të treta.

Dëme materiale nënkupton të gjitha prishjet ose dëmtimet aksidentale të një sendi, si dhe dëmtimet fizike të kafshëve.

Neni 9

RREZIQET E SIGURIMIT

Siguruesi do të paguajë për dëme shëndetësore, vdekje aksidentale dhe/ose dëme materiale shkaktuar aksidentalisht personave të tretë nga i Siguruari dhe personat që banojnë me të, të shkaktuara Vetem si rrjedhim:

9.1 I rënies së objekteve **nga objektet e banimit të përcaktuar** në Policë.

9.2 I ndodhjes të dëmeve ndaj personave të treta **brenda ambjentit të ndërtesës** së siguruar.

Do të mbulohen shpenzimet mjekësore për dëmet shëndetësore të personave të tretë për një periudhë kohore 12 muaj.

Ky sigurim nuk do të mbulojë:

a. Dëmet shëndetësore dhe materiale të personave të përcaktuar si "të Siguaruar" në Police.

b. Dëmet shëndetësore dhe materiale shkaktuar personave të tretë nga:

- Ushtimi i aktivitetit profesional;
- Gjuetia;
- Ashensorët;
- Mjetet motorike;
- Anijet;
- Mjetet fluturuese;

c. Dëmet e ndodhura gjatë praktikimit të të gjitha aktiviteteve sportive të ushtruara në një klub, shoqëri ose federate, nga personat e përcaktuar si të Siguaruar;

d. Dëmet shëndetësore ose materiale shkaktuar personave të tretë nga një pronë e marrë me qera, përdorim ose e lenë në mirëbesim të të Siguaruarit;

e. Demet e shkaktuara nga përdorimi ose mbajtja e eksplozivit në objektin e banimit të siguruar;

Limiti maksimal i Përgjegjësisë për dëmet materiale dhe/ose shëndetësore që mund t'u shkaktohen palëve të treta si me lart, do të jetë EUR 5,000 (pesemije euro).

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni 10

PËRJASHTIME TË PËRGJITHËSHME

Siguruesi nuk do të paguajë për dëme ose shpenzimeve të rrjedhura nga shkaqet e mëposhtme. Dëme të tilla nuk do të paguhet, panvaresisht çdo shkaku tjetër që mund të ketë ndikuar në ndodhjen e tyre.

10.1 Shpërthimi bërthamor, rrezatimi bërthamor dhe ndotja radioaktive.

10.2 Lufta ose çdo lloj invazioni, luftime të tjera të armatosura pavarësisht nëse është deklaruar lufta ose jo, lufta civile.

10.3 Turbullira civile, revolucione, lëvizje separatiste, kryengritje popullore, rebelime, revolta, puce, grushte shteti, eksode.

10.4 Konfiskime, rekuizime, shtetëzime të detyruara të kryera me urdhër nga cfarëdo lloj qeverie apo autoriteti shtetëror.

10.5 Trazira, greva, lokauti, sabotimi, akteve terroriste. Terrorizëm do të konsiderohet kryerja e veprimeve/mosveprimeve të dhunshme ndaj pronës nëpërmjet vjedhjes, dëmtimeve e shkatërrimeve masive që kanë si qëllim turbullimin e rendit publik dhe ngjalljen e frikës e të pasigurisë së publikut.

10.6 Shpalljen e ligjit të luftës, deklarimit dhe vendosjes së gjendjes së jashtëzakonshme, anarkia dhe mosfunksionimi i shtetit, qoftë edhe në pjesë të caktuara të vendit.

10.7 Nëse në rastin e një dëmi Siguruesi përdor të drejtën e tij për të mos dëmshpërblyer në bazë të përjashtimeve, i Siguruari do të jetë përgjegjës për të provuar se dëmi që ka ndodhur nuk është shkaktuar direkt ose indirekt në lidhje me këto përjashtime.

10.8 Dëmet vijuese të cdo lloji dhe natyre. Dëme vijuese do të konsiderohen dëmet indirekte (jo të drejtpërdrejta) që vijnë si pasojë e një dëmi kryesor, si dëme për shkak të vonesave, ndërprerjes së biznesit etj...P.sh: Shkatërrimi i një pasurie nga zjarri ose termeti është dëm direkt, por humbja e fitimit që shkaktohet nga ndërpreja e biznesit në vendin ku ka ndodhur dëmi është dëm vijues (jo i drejtpërdrejtë).

10.9 Në rastin kur i Siguruari ka kryer deklarime ose ka paraqitur dokumente të rreme/jo te verteta.

10.10 Demet ose humbjet e parave, letrave me vlere, instrumenteve financiare, sendeve me vlere si bizhuteri etj. që ndodhin për shkak të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

Neni 11

PERIUDHA E SIGURIMIT.

Periudha e sigurimit si rregull është jo më pak se një vit, përveç rasteve kur në kontratën e sigurimit përcaktohet ndryshe, por ne cdo rast jo më pak se tre muaj.

Sigurimi hyn në fuqi në orën 24^{oo} të datës së treguar në Policën e Sigurimit, me kusht që të jete paguar primi i sigurimit. Këto dispozita aplikohen në të gjitha ndryshimet që mund të kryhen më pas në kontratë.

Kontrata përfundon në afatin e përcaktuar në policë. Siguruesi do të njoftojë të Siguararin për përfundimin e afatit të kontratës 15 ditë përpara. Në rast se i Siguarari dëshiron të rinovojë kontratën me kushte të ndryshme nga kontrata ekzistuese, atëherë ai duhet të rideklarojë rrethanat thelbësore për vlerësimin e rrezikut si dhe shumat e siguruara. Përgjegjësia e Siguruesit do të fillojë në datën e përcaktuar në kontratë, edhe nëse pagesa e primit të sigurimit kryhet më parë.

Neni 12

PRIMI I SIGURIMIT

Primi per tu paguar do te përcaktohet në Policën e Sigurimit.

Kur i Siguarari nuk paguan primin e sigurimit ose kestin e pare në afatin e caktuar, sigurimi pezullohet deri ne oren 24:00 te dites qe i Siguarari paguan shumen qe detyrohet. Në rastin kur primi i sigurimit do t'i paguhet Siguruesit me këste, kësti i pare nuk mund të jetë më i vogël se 40 % e primit të sigurimit.

Në rast se i Siguarari nuk e paguan kestin pasardhës në afatin e caktuar në Policë: (i) Siguruesi ka të drejtë të zgjidhë Kontratën e Sigurimit, ose (ii) Siguruesi do të dëmshpërblejë dëmin në përpjestim me shumën e primit të paguar.

Neni 13

PJESA E ZBRITSHME

Në rastet e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit do të zbatohet pjesa e zbritshme dhe/ose franshiza. Per pasoje, ne cdo rast dëmi Siguruesi do të zbresë nga dëmshperblimi i llogaritur pjesën e zbritshme të përcaktuar në Policën e Sigurimit në shumë absolute dhe/ose në përqindje. Siguruesi nuk do të paguajë dëme të veçanta që janë nën shumën e përcaktuar si franshizë në Policën e Sigurimit. Masat e pjesës së zbritshme dhe/ose të franshizës janë të përcaktuara në Policë.

Neni 14

TË DREJTA DHE DETYRIME TË PALËVË

14.1 I Siguarari, në kohën e lidhjes së Kontratës së Sigurimit, duhet të informojë me shkrim Siguruesin për të gjitha rrethanat e njohura prej tij dhe që janë thelbësore për vlerësimin e rrezikut. Rrethanat janë thelbësore nëse ato janë të një natyre të tillë, që mund të ndikojnë në vendimin e Siguruesit për të përfunduar ose jo kontratën, apo për kushtet që duhet të vendosë. Ky detyrim është i vlefshëm edhe për Përfituesin, nëse vërtetohet nga Siguruesi se ai kishte dijeni për keto rrethana ose pasaktësinë e deklarimeve apo harresave në lidhje me rrezikun. Siguruesi nuk është i detyruar të dëmshpërblejë kur shkak i dëmit është një rrethanë që ndikonte mbi rrezikun, të cilën i Siguarari e ka ditur dhe nuk e ka deklaruar.

14.2 I Siguarari duhet të deklarojë të gjitha dëmet që mund t'i kenë ndodhur dhe që mund të jenë vërtetuar nga organet kompetente.

14.3 Në rast dëmi, i Siguarari duhet të përdorë të gjitha mjetet dhe të marre të gjitha masat objektivist te nevojshme, për të ndaluar përhapjen e mëtejshme të tij, për të shpëtuar objektet e siguruara dhe të kujdeset për to.

14.4 I Siguarari duhet të njoftojë Siguruesin me shkrim ose nepermjet e-mailit brenda 24 orëve nga ndodhja e dëmit. Gjithashtu i Siguarari duhet të njoftojë menjëherë organet e rendit (në rast vjedhje) dhe njesitë zjarrfikëse (në rast dëmi tjetër si termeti etj).

14.5 I Siguarari duhet të paraqesë kërkesën për dëmshpërblim, ku të përshkruhen:

14.6 Rrethanat e ndodhjes së dëmit.

14.6.1 Shkaqet për të cilat ai dyshon se ka ndodhur dëmi.

14.6.2 Natyrën dhe shumat e përafërta të dëmit.

14.6.3 Sigurimet e tjera që mbulojnë të njëjtat rreziqe.

14.7 I Siguarari duhet të informojë Siguruesin për ndryshimet e mëposhtme, në mënyrë që Siguruesi të rillogarisë primin dhe Kontrata e Sigurimit dhe të jetë e vlefshme.:

14.7.1 Nëse ndërron banesë.

14.7.2 Nëse ndryshon destinacionin e përdorimit të ambientit: p.sh: rregullon një pjesë të banesës me qëllim që të ushtrojë profesionin.

14.7.3 Nëse zgjeron banesën ose ben ndryshime të tjera strukturore.

I Siguarari duhet të vërë në dijeni Siguruesin në një afat kohor prej 15 ditësh, për çdo ndryshim që mund të ndodhë, duke filluar që nga momenti i ndryshimit.

14.8 I Siguarari është i detyruar të njoftojë Siguruesin për të gjitha ndryshimet e bëra në banesën e siguruar në rast se këto ndryshime rrisin rrezikun. Me rritje të rrezikut do të kuptohen rrethanat që janë thelbësore nëse ato janë të

një natyrë të tillë që mund të influencojnë vendimin e Siguruesit për të përfunduar ose jo kontratën, apo për kushtet që duhet të ndryshojnë. Në këtë rast Siguruesi ka të drejtë :

14.8.1 Të zgjidhë kontratën duke paralajmëruar të Siguruarin 10 ditë më parë.

14.8.2 Të propozojë një prim shtesë. Në qoftë se i Siguruarit refuzon të paguajë primin shtesë, Siguruesi ka të drejtë të zgjidhë kontratën në një periudhë prej 15 ditësh nga data e këtij refuzimi ose heshtjes së Siguruarit.

14.9 Nëse i Siguruarit nuk e njofton Siguruesin në lidhje me shtimin e rrezikut, ky i fundit, në rast të një kërkesë për demshpërblim, ka të drejtë të reduktojë proporcionalisht shumën për tu paguar, në proporcionin për të cilin Siguruesi është përgjegjës, i cili llogaritet duke e krahasuar primin aktual si një përqindje mbi primin të cilin Siguruesi do të kishte aplikuar nëse do të kishte dijeni mbi rrezikun e shtuar

Në rast të deklarimit të rremë me qëllim nga e të Siguruarit, kontrata do të konsiderohet e pavlefshme. Në këtë rast primet e paguara nuk i kthehen të Siguruarit, gjithashtu ai duhet të rimbursojë Siguruesit pagesat e dëmeve, që mund të ketë përfituar prej këtij të fundit.

Neni 15

SIGURIME TË TJERA

15.1 Në qoftë se i Siguruarit ka siguruar banesën tek më shumë se një Sigurues për të njëjtat rreziqe, ai duhet të njoftojë menjëherë me shkrim Siguruesit, emrin e siguruesit tjetër dhe shumën e siguruar. Kur i Siguruarit me dashje ose për shkak të pakujdesisë nuk plotëson detyrimet e mësipërme, Siguruesi ka të drejtën e zgjidhjes së kontratës së sigurimit dhe/ose mospagimin e dëmshpërblimit.

15.2 Nëse në momentin e ndodhjes së një dëmi sipas kësaj kontrate ekzistojnë sigurime të tjera, të cilat mbulojnë të njëjtin dëm, masa e dëmshpërblimit që përfiton i Siguruarit nga të gjitha kontratat e sigurimit nuk mund të jetë më e lartë sesa masa e dëmit minus pjesën e zbritshme. Vlera e dëmshpërblimit do të ndahet proporcionalisht midis shoqërive të sigurimit sipas shumave të siguruara.

15.3 Nëse i Siguruarit kryen sigurime të tjera me qëllim që të arrijë përfitime të paligjshme, kontrata e sigurimit quhet e pavlefshme dhe Siguruesi mban primin e sigurimit.

Neni 16

TRANSFERIMI I PRONËS

Në rastin e transferimit të pronës së siguruar, (si rrjedhim i vdekjes së të Siguruarit, shitjes etj) sigurimi vazhdon me të njëjtat kushte për trashëgimtarin, gjithashtu edhe për blerësin etj. nëse ai dhe Siguruesi bien dakort, në të kundërt kontrata e sigurimit quhet e zgjidhur. Në qoftë se i Siguruarit shet banesën e tij, ai i detyrohet Siguruesit për pagesën e primit të percaktuar deri në momentin e shitjes, gjithashtu edhe për pjesën e primit ende të papaguar deri në momentin kur ka njoftuar për shitjen. Në momentin që Siguruesi merr këtë informacion, njofton blerësin për zgjidhjen e kontratës ose vazhdimësinë e saj në qoftë se blerësi është dakort me kushtet e kontratës.

Të drejtat dhe detyrat e të Siguruarit në këtë kontratë nuk mund të kalojnë tek një person tjetër pa miratimin me shkrim të Siguruesit. Ky miratim do të shoqërohet me ndryshimet përkatëse në Policën e sigurimit.

Neni 17

17.1 MBISIGURIMI

Nëse shuma e siguruar e tejkalon ndjeshëm vlerën e sigurimit, atëherë si Siguruesi ashtu edhe i Siguruarit mund të kërkojnë zvogëlimin e shumës së siguruar, dhe primi i sigurimit do të zvogëlohet përkatësisht.

Nëse i Siguruarit lidh kontratën e Sigurimit me qëllim që të arrijë përfitime të paligjshme nga mbisigurimi, kontrata quhet e pavlefshme. Siguruesi ka të drejtën e mbajtjes së primit të sigurimit.

17.2 NËNSIGURIMI

Nëse në momentin menjëherë para ndodhjes së ngjarjes së sigurimit shuma e siguruar është më e ulët se vlera e sigurimit, atëherë dëmshpërblimi do të shumëzohet me koeficientin e nënsigurimit, i cili përcaktohet si raport i shumës së siguruar ndaj vlerës së sigurimit.

Neni 18

MASHTRIMI

Sigurimi nuk mund të jetë shkak përfitimi për të Siguruarin, ai garanton vetëm riparimin e humbjeve reale ose të atyre për të cilat Siguruesi është përgjegjës. I Siguruarit, që në mënyrë të qëllimshme, zmadhon shumën e dëmit, pretendon shkatërrimin e objekteve, të cilat nuk kanë ekzistuar, fsheh ose merr vjedhurazi të gjitha ose pjesë të objekteve të siguruara, përdor me vetëdije si justifikim mjete të mashtrimit ose dokumenta të rreme, humb të gjitha të drejtat e sigurimit për dëmin në fjalë.

Neni 19

KALIMI I TË DREJTAVE.

Kur Siguruesi ka paguar një dëm në bazë të Kontratës së Sigurimit, ai ka të drejtë të marrë përsipër të drejtat ligjore mbi pasurinë e të Siguruarit kundrejt përgjegjësit të dëmit (palës së tretë), deri në masën e dëmshpërblimit të paguar.

Neni 20

Ekspertimi dhe Dëmshpërblimi

20.1 Siguruesi brenda 10 ditëve nga njoftimi i të Siguruarit duhet të fillojë ekspertimin e dëmit të ndodhur.

20.2 Në rastet kur i Siguruarit nuk pranon plotësisht ose pjesërisht aktekspertimin e Siguruesit, e njofton atë me shkrim brenda tre ditëve nga marrja e këtij akti.

20.3 Detyrimi i Siguruesit për dëmshpërblim kufizohet deri në masën e shumës së siguruar. Dëmshpërblimi nuk do të jetë më i lartë se masa e humbjes, edhe nëse në momentin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit shuma e siguruar është më e lartë se vlera e sigurimit.

20.4 Siguruesi mund të shtyjë kohën e pagesës:

20.4.1 për aq kohë sa ekzistojnë dyshime mbi të drejtën e të Siguruarit për të marrë pagesën;

20.4.2 në qoftë se janë filluar hetime penale në lidhje me ngjarjen e sigurimit kundër të Siguruarit;

20.4.3 për aq kohë sa i Siguruarit nuk paraqet dhe plotëson dokumentat e kërkuara nga Siguruesi.

20.5 Siguruesi, brenda 30 ditëve nga data e marrjes së dokumenteve të dëmit nga I Siguruarit, detyrohet që:

20.5.1 të bëjë pagesën në rast të dëmshpërblimit.

20.5.2 të shpjegojë arsyet e refuzimit, në rast të refuzimit.

Siguruesi do të dëmshpërblejë të Siguruarin për dëmin duke paguar me para, duke riparuar ose zëvendësuar sipas zgjedhjes së Siguruesit.

Neni 21

E DREJTA E PADISE

E drejta për ngritjen e padise për pretendimet që rrjedhin nga kontrata e sigurimit duhet të ushtrohet brenda 2 viteve nga momenti i ndodhjes së ngjarjes së siguruar.

Neni 22

NDËRPRERJA E KONTRATËS

22.1 Kjo Policë mund të përfundojë në çdo kohë me kërkesë të të Siguruarit dhe në këtë rast Siguruesi do të mbajë primin për kohën që Polica ka qenë në fuqi, si dhe 20% të primit të sigurimit të pashfrytëzuar për shpenzime administrative.

22.2 Kjo Policë gjithashtu mund të përfundojë në çdo kohë me dëshirën e Siguruesit duke njoftuar të Siguruarin lidhur me këtë ndërprerje dhe në këtë rast Siguruesi do të jetë i detyruar të kthejë primin në proporcion me kohën e mbetur nga anulimi i Policës deri në përfundim të saj.

Neni 23

MBARIMI I KONTRATËS

Kjo kontratë sigurimi përfundon automatikisht me përfundimin e periudhës së sigurimit.

Neni 24

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Për mosmarrëveshjet midis Siguruesit dhe të Siguruarit kur nuk zgjidhen me mirëkuptim midis paleve, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

Neni 25

Për gjithcka çfare nuk parashikohet në kete kontrate, do te aplikohen dispozitat dhe parimet e Kodit Civil te Republikes se Shqiperise.

26. Dispozita te fundit

26.1 Klauzola e përjashtimit të sulmeve kibernetike

Pavarësisht dispozitave të përmbajtjes së ndryshme brenda këtij sigurimi ose çdo miratimi pranohet që ky sigurim përjashton humbjen, dëmtimin real dhe personal të pasurisë, kostot ose shpenzimet e çfarëdo natyre, të shkaktuara direkt ose indirekt të shkaktuara nga çdo sulm kibernetik, që rrjedhin nga përdorimi si mjet për të shkaktuar dëm i cdo kompjuteri, sistemi kompjuterik, programi soft kompjuterash, kode keqdashesh, virusesh kompjuterike ose cdo sistemi apo paisje tjeter elektronike.

26.2 Klauzola e përjashtimit të semundjeve ngjitese

Pavarësisht parashikimeve në këtë Policë Sigurimi, Siguruesi nuk do të ofrojë mbulim dhe Siguruesi nuk do të jetë i detyruar të paguajë ndonjë kërkesë për dëmshpërblim për cdo dëm që lidhet me dëme trupore (përfshirë Stresin Emocional ose traumën mendore ose fobinë), cdo lloj demesh ose humbjes materiale, të cilat janë ose pretendohet të

jene shkaktuar nga, te ndikuara nga ose ne cdo menyre te lidhura me: Sindromen e fituar
te imunitetit te ulur (SIDA/AIDS) ose agjeneteve patologjik te tij ose hepatiti;
Semundjet ngjitese: Me semundje ngjitese do te kuptohet cdo semundeje, e cila mund te transmetohet midis njerëzve, kafshëve ose bimëve, ose me anë të ndonjë substanca ose agjenti nga ndonjë organizëm në një organizëm tjetër, kur:
- substanca ose agjenti përfshin, por nuk kufizohet vetëm në një virus, bakter, parazit ose organizëm tjetër ose ndonjë ndryshim të tij, qoftë ai që konsiderohet i gjallë ose jo, dhe - metoda e transmetimit, qoftë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, përfshin por nuk është e kufizuar në, transmetimin në ajër, transmetimin e lëngjeve trupore, transmetimin nga ose në ndonjë sipërfaqe ose objekt, të ngurtë, të lëngshëm ose gaz ose midis organizmave, dhe
- sëmundja, substanca ose agjenti mund të shkaktojë ose kërcënojë dëmtimin e shëndetit të njeriut ose të mirëqenies njerëzore ose mund të shkaktojë ose kërcënojë dëm, përkeqësim, humbje të vlerës së, tregtueshmërinë ose humbjen e përdorimit të pasurisë

26.3 Klauzola e Sanksioneve

Pavarësisht parashikimeve në këtë Policë Sigurimi, Siguruesi nuk do të jetë i detyruar të paguajë ndonjë kërkesë për demshpërblim ose të japë ndonjë përfitim sipas kësaj kontrate, nëse ofrimi i një mbulimi të tillë, pagesa e një kërkesë të tillë ose dhënia e një përfitimi të tillë do të ekspozonte Siguruesin ndaj ndonjë sanksioni, ndalimi ose kufizimi, sipas Rezolutave të Kombeve të Bashkuara ose sanksioneve tregtare ose ekonomike, ligjeve ose rregulloreve të Bashkimit Europian, gjithashtu sipas Ligjit Shqiptar, Mbretërisë së Bashkuar ose Shteteve të Bashkuara të Amerikës.